



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
KOMISIONI I APELIMIT

Nr. 1525 Prot.

Elbasan, më 10.06.2024

VENDIM

Nr. 1, Datë 10.06.2024

“PËR

**KONSTITUIMIN E KOMISIONIT TË APELIMIT DHE ZGJEDHJEN E
KRYETARIT DHE SEKRETARIT”**

Në zbatim të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve, për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (neni 37), Vendimit të Senatit Akademik Nr.32, datë 17.05.2024 “Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit të Apelimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (shkresa nr.1231/2 Protokolli datë 17.05.2024) si dhe Vendimit Nr.35, datë 07.06.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin e Senatit Akademik Nr.32, datë 17.05.2024” “Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit të Apelimit në Universitetin e Elbasanit” “Aleksandër Xhuvani”, mbledhet sot në datë 10.06.2024, në orën 09:00, Komisioni Apelimit, posaçërisht i formuar me detyrën e shqyrtimit dhe vendimarrjes të arsyetuar për çdo ankim lidhur me vendimet e marra nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ).

Paraprakisht, evidentohet se: Sot, në datë 10.06.2024, ky Komision përbëhet nga: PhD. Cand. Armelda Teta, Dr. Zyhra Gripshi, Dr Ardita Dylgjeri, Dr. Mimoza Shkëmbi, Prof. As. Dr. Rezarta Tahiraj.

Kjo përbërje aktuale e Komisionit reflekton antarësimin e dy antarëve të rinj të cilët u aprovuan nga Senati Akademik me Vendimin Nr.32, datë 17.05.2024 dhe me Vendimin Nr.35, datë 07.06.2024, pas paraqitjes së dorëheqjes së pakthyeshme të anëtarit dhe njekohësisht kryetarit të këtij komisioni si dhe sekretarit dhe anëtarit gjithashtu të këtij komisioni. Pra, Komisioni i Apelit thirret sot në përmbushje të afateve ligjore si dhe kriterëve ligjore që parashikohen në nenin 37 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve, për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Pasi anëtarët u njohën më përmbajtjen e Vendimit Nr.35, datë 07.06.2024, të Senatit Akademik “Për disa ndryshime në Vendimin e Senatit Akademik Nr.32, datë 17.05.2024 “Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit të Apelit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, në zbatim të Nenit 37 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve, për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, me unanimitetin e të gjithë antarëve të pranishëm vendoset si në vijim:

- 1- Konstituimi i Komisionit të Apelit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.
- 2- Zgjedhjen e Kryetarit të Komisionit të Apelit dhe Sekretarit të këtij Komisioni. Roli i kryetarit të Komisionit të Apelit i jepet Prof.as.Dr. Rezarta Tahiraj. Roli i sekretarit të Komisionit të Apelit i jepet PhD cand. Armelda Teta.

Kryetari i Komisionit të Apelit
Prof.as.Dr. Rezarta Tahiraj

Sekretar i Komisionit të Apelit
Ph.D. cand Armelda Teta

Anëtar
Dr. Zyhra Gripshi

Anëtar
Dr. Ardita Dylgjeri

Anëtar
Dr. Mimoza Shkëmbi